



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Komuna e Lipjanit

# Strategjia mbi Përfshirjen Sociale 2022-2024

Lipjan, qershor, 2022

## Përmbajtja

Lista e shkurtesave.....	2
Përmbledhjeekzekutive.....	2
1. Hyrje.....	3
2. Metodologjia.....	4
3. Sfondi.....	5
3.1 Korniza ligjore.....	5
3.2 Roli dhe përgjegjësia në ofrimin e shërbimeve sociale në nivel lokal.....	6
3.3 Komuna e Lipjanit.....	6
3.4 Identifikimi i grupeve te ndjeshme.....	7
3.5 Komuna e Lipjanit .....	6
4. Vizioni dhe Qëllimet Strategjike.....	7
5. Misioni.....	8
6. Plani i veprimit .....	9
7. Shtojcat.....	11

# Imri AHMETI

Kryetar i Komunës së Lipjanit

Fjala e Kryetarit,

Diversiteti dhe promovimi i barazisë sociale është specifikë e Komunës e Lipjanit që reflekton në një vendbanim të të sigurtë dhe të pranueshëm për të gjithë pavarësisht gjinisë, moshës, nacioanlitetit apo karakteristikave të tjera. Ne thjeshtë e çmojmë shumë diversitetin dhe zotohemi në planin komunal të veprimit për përfshirje sociale. Ne po ndërtojmë një sistem të mbrojtjes dhe përfshirje sociale.

Komuna e Lipjanit po ndërmerr masa për të promovuar shërbime sociale duke ua përshtatur nevojave në terren, praktikave të mira dhe mundësive tona. Ne i japin rëndësi të veçantë kujdesit shëndetësor, mirëqenies dhe shërbimeve sociale, mbështetjes për familje dhe posaqërisht grupeve të ndjeshme, duke filluar nga të moshuarit, prindërit vetushqyes, personat me aftësi të kufizuara, të mbijetuarit/at e dhunës në familje dhe në përgjithësi dhunës së bazuar në gjini, si dhe azilkërkuesve, refugjatëve dhe kategorive të tjera të të huajve. Komuna e Lipjanit poashtu ka fokus specifik në punësimin dhe mirëqenien e të rinjve.

Identiteti i komunës tonë njihet më së miri përmes zotimit që kemi bërë ndaj avansimit të sistemit të mbrojtjes sociale dhe politikave gjithëpërfshirëse për të gjithë personat në nevojë, pavarësisht statusit të tyre apo kohëzgjatjes së qëndrimit në territorin e komunës. Ne thjeshtë nuk mund të mbyllim sytë kur ballafaqohemi me çështje e grupe të ndjeshme, nuk mund ta injorojmë problemin e vazhdueshëm të varfërisë, strehimit, nevojave për kujdes shëndetësor, dhunës në familje apo fenomeneve të tjera që pengojnë mirëqenien e njerëzve para të cilëve jemi zotuar.

Këto fenomene janë sfiduese për çdo udhëheqës në botë, por kam besimin se ne mund të ia dalim më mirë sesa të tjerët sepse karakterizohemi nga mënyra e adresimit dhe përballjes të çështjeve që cenojnë mirëqenien e njerëzve në komunën tonë.

Komuna e Lipjanit njëzëri zotohet që do të punojë në drejtim të realizimit të Planit të Veprimit të Strategjisë për Përfshirje Sociale, duke u shëndrruar në komunë model për të gjithë Kosovën dhe më gjerë.

Ky do të jetë identiteti jonë dhe ju ftoj të gjithëve që ta zhvillojmë më tutje!

I juaji,

Imri AHMETI

Kryetar i Komunës së Lipjanit

## Lista e shkurtesave

MFPT Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

QPS Qendra për Punë Sociale

DSHPS Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale

MAPL Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

OshC Organizatat e Shoqërisë Civile

## Përmbledhje Ekzekutive

Qasja në një sistem të duhur të mbrojtjes sociale është një e drejtë themelore njerëzore dhe si e tillë paraqet pjesë të një rëndësie të veçantë në legjislacionin e vendit. Shërbimet sociale dhe familjare nënkuptojnë shërbimet publike përmes ofrimit të drejtpërdrejtë të përkujdesjes sociale, këshillimit ose në rastet e veçanta, ndihmë materiale për njerëzit në nevojë sociale . Thënë ndryshe ato janë shërbime të mirëqenies sociale të cilat ofrohen nga profesioniste të angazhuar në kryerjen e shërbimeve të tilla për të ndihmuar persona të pambrojtur ose grupet në nevojë. Ato duhet të ofrohen sipas pikëpamjes së parandalimit të problemeve sociale të individit, familjes, grupit dhe komunitetit, si dhe garantimit të sigurisë dhe kohezionit social të familjes dhe të shoqërisë. Strategjia për Përfshirjen Sociale 2022-2024 synon fuqizimin e sistemit ekzistues të shërbimeve sociale dhe adresimin jo vetëm të ofrimit të shërbimeve por mbështetjen me kuptim për integrimin e grupeve të ndjeshme në shoqëri, përmirësimin e shkathtësive dhe mundësive në të gjitha sferat e jetës. Kjo strategji është ndërtuar mbi vizionin e transformimit të *sistemit të mbrojtjes sociale në Komunën e Lipjanit nga ofrimi i shërbimeve të domosdoshme në shërbime që ofrojnë mbështetje për të gjithë personat në nevojë deri në përfshirjen e plotë në jetën institucionale dhe sociale.*

### I. Hyrje

Strategjia mbi Përfshirjen Sociale 2022 – 2024], adreson çështjet ndër-sektoriale në fushën e shërbimeve dhe të mbrojtjes sociale në Komunën e Lipjanit, të tilla si, (i) qasjen adekuate në shërbime sociale dhe familjare, si dhe shërbime të tjera publike, (ii) qasjen në informacion, komunikim dhe pjesëmarrje për personat me nevoja specifike (të institucionalizuar apo në komunitet), (iii) mbledhjen dhe menaxhimin e koordinuar të të dhënave, (iv) mbështetjen në zhvillimin e një sistemi efektiv të mbrojtjes sociale dhe (v) ofrimin e zgjidhjeve të qëndrueshme

për personat me nevoja specifike për qasje në shërbime publike (sociale, edukuese, shëndetësore).

Zhvillimi i këtij dokumenti është rezultat i punëtorive, konsultimeve dhe këshillimeve me profesioniste, eksperte dhe përfaqësues të institucioneve komunale në fushën e shërbimeve sociale, shëndetësisë, arsimit, punësimit, infrastrukturës dhe përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile dhe si i tillë adreson nevojat e përcjella nga institucionet zbatuese të shërbimeve përkatëse. Ky dokument reflekton parimet e decentralizimit dhe angazhimin e institucioneve lokale në përmirësimin e sistemit të ofrimit të shërbimeve dhe mbrojtjes sociale.

Strategjia synon fuqizimin e sistemit ekzistues të shërbimeve sociale dhe fokusohet në përfshirjen sociale dhe institucionale të të gjitha kategorive sociale, pavarësisht gjinisë, përkatësisë etnike, religjionit apo prejardhjes. Kjo strategji synon që të adresojë jo vetëm ofrimin e shërbimeve por mbështetjen me kuptim për integrimin e grupeve të ndjeshme në shoqëri, përmirësimin e shkathtësive, mundësive dhe dinjitetin e personave të paprivilegjuar në mënyrë që të marrin pjesë aktive në shoqëri.

Përveç fokusit të tanishëm në ofrimin e shërbimeve për kategori të caktuara, strategjia ka për synim që të përfshijë të gjitha grupet e ndjeshme, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara, të mbijetuarit e dhunës së bazuar në gjini dhe dhunës në familje, minoritetet etnike, të moshuarit, varësinë ndaj substancave psikoaktive dhe kategori e fenomene të tjera që krijojnë predispozita për cenueshmëri.

Strategjia merr parasysh përpjekje nacionale dhe lokale, përfshirë Ligjit mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare, rregulloret komunale dhe përpjekjet lokalet në përgjithësi. Për më tepër, veprimet e rekomanduara të përcaktuara në këtë Strategji fokusohen në fuqizimin e sinergjive ndër-institucionale në nivel lokal.

## II. Metodologjia

Strategjia mbi Përfshirjen Sociale 2022 – 2024 paraqet përpjekjet për të identifikuar nevojat dhe për të adresuar çështjet e shërbimeve dhe mbrojtës sociale, mbi bazën e të cilave është përcaktuar vizioni dhe objektivat strategjike të këtij dokumenti. Për këtë qëllim, Komuna e Lipjanit, përkatësisht drejtoritë relevante kanë përcaktuar listën e grupeve punuese për hartimin e strategjisë.

Procesi i hartimit të Strategjisë mbi Përfshirjen Sociale 2022 – 2024 ka filluar në vitin 2021 në kuadër të projektit “Fuqizimi i Zërit të Komunitetit për Zhvillim të Barabartë - AVLED” të implementuar nga Organizata Jo – qeveritare People in Need – PIN në bashkëpunim me zyrën e kryetarit të Komunës në Lipjan, përkatësisht drejtorive komunale dhe Organizatave të Shoqërisë Civile në fushën e shërbimeve dhe mbrojtjes sociale. Ndërsa, ekspertiza në hartimin e Strategjisë është ofruar nga ekspert vendor me mbështetjen e PIN.

Metodologjia e përdorur në hartim të kësaj strategjie përfshinë një proces të mbledhjes së të dhënave përmes një instrumenti të gjysmë-strukturuar, analize të situatës aktuale, punëtorive me grupet punuese brenda dhe jashtë vendit dhe konsultim të vazhdueshëm me akterete ndryshëmsipas fushave përkatëse.

Pjesëmarrës në këto grupe punuese kanë qenë përfaqësues të institucioneve lokale të tilla si: Qendra për Punë Sociale, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Drejtoria e Arsimit, Zyra për Barazi Gjinore, Shtëpia me Bazë në Komunitet dhe përfaqësues të organizatave si ofrues të shërbimeve sociale, përfshirë Youth Initiative for Human Rights, The Ideas Partnership dhe Youth Centre. Grupet punuese kanë adresuar nevojat dhe sfidat e shërbimeve sociale, në baze të cilave pastaj janë përcaktuar objektivat e përgjithshme dhe objektivat specifike të kësaj strategjie. Rrjedhimisht, nga objektivat specifike janë përcaktuar edhe aktivitetet specifike dhe kostot e tyre, të cilat janë shqyrtuar në vazhdimësi nga anëtarët e grupit punues.

Strategjia fillimisht është hartuar duke ndjekur metodologjinë e Teorisë së Ndryshimeve, por që me vonë me kërkesë të zyrës së kryetarit është adaptuar sipas udhëzimit administrativ nr.07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit.

### III. Sfondi

#### *Korniza Ligjore Nacionale mbi Shërbimet Sociale*

Legjislacioni për Shërbimet Sociale dhe Familjare në Kosovë, përbërë nga Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare, Ligji për Familjen, Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës, si dhe ligjet dhe aktet tjera që ndërlidhen me shërbimet sociale përfaqëson përpjekjet e orientuara institucionale në rregullimin dhe përmirësimin e shërbimeve sociale dhe familjare për personat në nevojë dhe për familjet e tyre.

Bartësit dhe ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare sipas legjislacionit në fuqi në nivel qendror janë:

Qeveria dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), e cila rolin e saj e përmbush përmes Departamentit të Politikave Sociale dhe të Familjes. Ndërkaq, ekzistojnë edhe disa mekanizma institucional që operojnë në kuadër të institucioneve dhe legjislacionit përkatës:

- Këshilli i përgjithshëm për Shërbimet Sociale dhe Familjare, si mekanizëm profesional dhe administrativ;
- Paneli për Vendosjen e fëmijëve në strehim familjar dhe adoptim, përgjegjës për mbikqyrjen e zbatimit të legjislacionit dhe procedurave profesionale nga ana e Qendrave për Punë Sociale;
- Shtëpitë për persona të moshuar dhe pa përkujdesje familjare; dhe

- Shtëpitë me bazë në Komunitet për Personat me aftësi të kufizuara – mendore, ngecje në zhvillimin mendor.

Ndërsa në nivel lokal bartës dhe ofrues të shërbimeve sociale janë:

- Komunat e Lipjanit, përkatësisht Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale;
- Qendra për Punë Sociale;
- Organizatat jo qeveritare.

Komuna e Lipjanit, përkatësisht DSHPS, poashtu ofron strehim familjeve të cilat kanë nevojë për strehim në Ndërtesën për Banim Sociale në Magure. Ndërkaq, ofron përkujdesje për fëmijët pa përkujdesje prindërore përmes familjeve strehuese.

Qasja adekuatë në sistemin e mbrojtjes sociale nga grupet e ndjeshme përfaqëson një të drejtë themelore njerëzore. Shërbimet sociale dhe ato të specializuara në mbështetje të personave të ndjeshëm mbeten thelbi i funksionimit të ofruesve të shërbimeve sociale. Me qëllim të përmirësimit të efektivitetit të shërbimeve sociale, në vitin 2009 është nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi në mes të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (në atë kohë kanë funksionuar të ndara si Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Financave) dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, ku palët janë dakorduar se komunat janë plotësisht përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve sociale.

Sipas Raportit të Komisionit Evropian për Kosovën (2020), komunat në gjithë Kosovën nuk kanë alokuar financim të qëndrueshëm afatgjatë për shërbime sociale; ndërkaq *një iniciativë për të përcaktuar financim prej grantit të përgjithshëm për shërbime sociale përmes ndryshimeve në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal ka mbetur në pritje për shumë vite.*

Targetimi i grupeve në nevojë në kuptimin e gjithëpërfshirjes sociale dhe mbrojtjes është ende një sfidë në gjithë Kosovën. *Qendrat për Punë Sociale (QPS) janë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve dhe tani më 40 QPS ofrojnë shërbime sociale në 38 komuna të Kosovës<sup>1</sup>; shërbime shtesë ofrohen edhe nga organizatat e shoqërisë civile.*

### ***Roli dhe përgjegjësia në ofrimin e shërbimeve sociale në nivel lokal***

Roli dhe përgjegjësit e komunave në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare përcaktohet me Ligjin për Shërbimet Sociale dhe Familjare, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe aktet nënligjore të nxjerra në mbështetje të zbatimit të këtyre ligjeve, si dhe me rregulloret të brendshme të nxjerra nga kuvendet komunale.

Komuna zbaton politikën, strategjitë dhe standardet e përcaktuara nga Ministria; nxjerr programin vjetor dhe afatmesëm të shërbimeve sociale, në bazë të analizës së gjendjes sociale dhe nevojave të popullsisë në territorin e saj; nxjerr vendim për të drejtat e zgjeruara dhe aktet e tjera me të cilat përcakton kushtet për realizimin e të drejtave dhe të masave të përcaktuara

<sup>1</sup>Monitoring and Evaluation of Social Services in Kosovo. Save the Children (2020)

me vendim dhe me programe; siguron mjetet për realizimin e të drejtave të përcaktuara me këtë Ligj dhe me vendimet e saja; siguron mjete për kryerjen e veprimtarive të shërbimeve sociale në territorin e komunës; dhe kryen edhe punë të tjera në realizimin e qëllimeve të mbrojtjes sociale.

Komuna përmes QPS ose organizatave të tjera qeveritare dhe joqeveritare, përfshirë edhe ndërmarrjet private, mund të ofrojë shërbime sociale dhe familjare.

Projektligji i ri për Shërbime Sociale dhe Familjare synon gjithë përfshirjen sociale përmes sektorit qeveritar dhe jo-qeveritar duke përfshirë edhe Ministrinë e Linjës, ndërkaq parasheh edhe të drejtën e komunave të zgjerojnë shërbimet e sociale përmes personave të tjerë fizik dhe juridik të cilët i rregullojnë marrëdhëniet e tyre me kontratë.

Qendra për Punë Sociale është institucion publik profesional komunal.

### ***Komuna e Lipjanit dhe përkujdesja për grupet e ndjeshme***

Statuti i Komunës së Lipjanit i miratuar më 2021, përcakton se Komuna ka kompetenca vetanake në pajtim me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale për ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç është përkujdesi për të cenueshmit, strehimin familjar, përkujdesin fëmijor, përkujdesin për të moshuarit, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave përkujdesëse, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e profesionistëve të mirëqenies sociale<sup>2</sup>, përfshirë këtu edhe njohjen e të drejtës për ndihmë sociale (me përjashtim të pensioneve). Përmes këtij Statuti, Kuvendi Komunal themelon drejtoritë komunale ku përfshihet edhe Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, në kuadër të së cilit u themelua Sektori për Përkujdesje Sociale. Drejtorati, përveç përgjegjësive shëndetësore, sa i përket ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare ushtron këto përgjegjësi:

- Koordinon dhe mbikëqyrë punën e Qendrës për Punë Sociale;
- Përkujdeset për sigurimin e strehimit për të pastrehët;
- Siguron përkujdesje ndaj kategorive të dala nga lufta, familjeve të dëshmorëve, martirëve, invalidëve dhe veteranëve të luftës së UÇK-së
- Kryen edhe punë të tjera nga lëmi i mbrojtjes shëndetësore dhe sociale në pajtim me dispozitat ligjore.

Rregulloret e finalizuar në nivel komunal:

- 1) Rregullore për Përkujdesjen dhe Mbrojtjen e Fëmijës, miratuar nga Kuvendi i Komunës në qershor të vitit 2021. Kjo rregullore përcakton rregullat dhe procedurat për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës, në pajtim me ligjin për mbrojtjen e fëmijës dhe kompetencave vetanake të Komunës së Lipjanit, me qëllim të mbrojtjes së fëmijës nga të gjitha format e dhunës fizike dhe mendore, abuzimit, ndëshkimit trupor,

---

<sup>2</sup>Neni 9 paragrafi (k) i Statutit të Komunës së Lipjanit.

keqpërdorimit, shfrytëzimit, neglizhimit apo ndonjë forme tjetër që vë në rrezik jetën, sigurinë, shëndetin, edukimin, arsimimin dhe zhvillimin e fëmijës, si dhe përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e subjekteve për mbrojtjen e fëmijës

- 2) Rregullorja për Ndarjen e Subvencioneve, u miratua nga Kuvendi Komunal në qershor 2019, me qëllim për të ndihmuar me mjete financiare pa kthim, personat juridik dhe fizik që jetojnë dhe zhvillojnë aktivitetet në territorin e Komunës së Lipjanit, përveç tjerash për avancimin dhe zhvillimin e aktiviteteve, edukativo arsimore, mbrojtjes shëndetësore dhe sociale. Me këtë rregullore përcaktohen kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së mjeteve financiare pa kthim. Po ashtu, një nen i veçantë përcakton subvencionet për shëndetësi dhe përkujdesje sociale, ndërkaq parasheh edhe subvencionet për personat juridik, si organizatat joqeveritare aktive.

*Ofrimi i shërbimeve sociale në Komunën e Lipjanit.* Komuna e Lipjanit ndodhet në Kosovën qendrore dhe mbanë përgjegjësi për 57,605 njerëz që banojnë në qytetin e Lipjanit dhe 62 fshatrat përreth.

Ekonomia e komunës së Lipjanit/Lipljan është kryesisht e bazuar në agrikulturë dhe bizneset e vogla tregtare; ndërkaq nuk ka të dhëna të besueshme mbi numrin e njerëzve të punësuar në sektorin privat edhe pse përafërsisht 2,110 biznese të regjistruara privatë operojnë në komunë.

Në fushën e përfshirjes sociale dhe ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare, vendndodhja në komunën e Lipjanit të këtyre institucioneve kërkon shërbime më të fuqizuara dhe të zgjeruara sociale:

- Qendra Korrektuese për Gra dhe të Mitur në Lipjan;
- Qendra e Paraburgimit;
- Qendra për Strehimin e të Miturve;
- Qendra për Azil në Magure/Lipjan;
- Aeroporti ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari";
- Strehimorja e Sigurisë së Lartë për personat e trafikuar;

Duke marrë parasysh që Komuna e Lipjanit përfaqëson edhe lokacionin e institucioneve të mësipërme që kërkojnë edhe ofrimin e shërbimeve sociale, kohezioni social është i një rëndësi të veçantë.

*Kategoritë sociale në Komunën e Lipjanit dhe ofrimi i shërbimeve specifike.* Qendra për Punë Sociale gjatë vitit 2021 ka asistuar gjithsej 1045 raste në nevojë, ku kategoria që dominon me mbi 50 për qind janë shërbimet ofruar për fëmijët me aftësi të kufizuara pasuar nga rastet e dhunës në familje.

**Tabela 1: Kategoritë sociale që kanë pranuar shërbimë në Qendrën për Punë Sociale në Komunën e Lipjanit gjatë vitit 2021**

Kategoria	Numri i rasteve
Fëmijët e braktisur	1

Klientët vendor për Adoptim.	2
Fëmijët e keqtrajtuar (lënë pas dore).	13
Fëmijët me sjellje asociale.	24
Viktimat e dhunës në familje	79
Klient në nevojë për këshillime martesore.	31
Klient në nevojë për mendim profesional lidhur me lidhjen e martesës para moshës madhore.	10
Të moshuarit në nevojë për shërbime.	3
Re-integrimi i fëmijëve	7
Viktimat e krimeve seksuale	7
Fëmijët me Aftësi të Kufizuara.	48
Të rritur me aftësi të kufizuar	4
Të miturit e pa shoqëruar me mbrojtje ndërkombëtare .	16
Klient në ISSH	0
Klient në Shtëpinë për përkujdesje komunitet.	10
Klientë në SHPPMPF	2

Ndërkaq, QPS në Lipjan gjatë vitit 2021 ka ofruar gjithsej 2290 shërbime për kategoritë e përshkruara më sipër, ku pjesa dërrmuese janë kategorizuar si intervenime të përgjithshme (1440 shërbime) pasuar nga strehimi institucional për fëmijë, shërbime për fëmijë me aftësi të kufizuara dhe intervenim për viktimat në kujdestari.

Ndërkaq, përfitues të skemës sociale ka qenë të gjithë ata të cilët të drejtën e tyre e realizojnë sipas Ligji të Skemës së Ndhimave Sociale, Nr. 2003/15 dhe Ligjit Nr.2011/04-L-096 Për Ndryshim Plotësimin e këtij Ligji. Përfundimisht, shfrytëzues të ndihmës sociale kanë qenë edhe shtetasit e huaj të cilët:

- a) kanë leje qëndrimi në Kosovë;
- b) personat në cilësinë e azilkërkuarit;
- c) personat në cilësinë e refugjatit dhe
- d) personat të cilët gëzojnë mbrojtje të përkohshme dhe plotësuese''

**Tabela 2: Numri i përfituesëve dhe totali sipas skemave sociale gjatë vitit 2021**

Skemat	Asistencë sociale Janar –Dhjetor	Azilkërkuar	Strehim familjar	Skema FFAK

Numri i përfituesve	Janar-Dhjetor 1245-1305	Janar-Dhjetor 92-46	<b>16</b>	<b>101</b>
<b>Totali- €</b>	<b>2.819.838.75</b>	<b>76.137.50€</b>	<b>19,200.00€</b>	<b>117,800.00€</b>

Identifikimi i grupeve të ndjeshme. QPS realizon identifikimin e rasteve potenciale në terren, përfshirë rastet e dhunës në familje, neglizhimit me fëmijë/e drejta prindërore, abuzimet, braktisja e shkollimit e raste të tjera të ndjeshme. Referimi i rasteve bëhet përmes qytetarëve dhe institucioneve kompetente.

Kategoritë e grupeve të ndjeshme të identifikuar në Komunën e Lipjanit në kuadër të takimeve të grupit punues të Strategjisë për Përfshirjen Sociale janë:

- Personat me aftësi të kufizuara;
- Rastet e Dhunës në Familje dhe mbi Baza Gjinore;
- Fëmijët dhe të rinjtë nga familjet në gjendje të vështirë socio-ekonomike;
- Personat që u takojnë komuniteteve minoritare të marginalizuara;
- Prindërit vetushqyese;
- Të miturit delikuent;
- Të miturit e pashoqëruar;
- Të miturit e përfshirë në punë të rënda;
- Personat e moshuar;
- Azilkërkuesit dhe të huajt;
- Personat e riatdhesuar;
- Viktimat e trafikimit me qenie njerëzore;
- Personat e varur nga substancat psikoaktive.

Vëmendje specifike në ofrimin e shërbimeve sociale në komunë i dedikohet të gjitha kategorive të ndjeshme dhe në nevojë për shërbime sociale dhe familjare.

Buxheti vjetor për QPS në Lipjan është 12.000.00€ për mallra dhe shërbime. Ndonëse QPS nuk ka mundësi që të transferojë përgjegjësi të saj, ajo bashkëpunon dhe kontraktton përmes Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale shërbime përmes organizatave të shoqërisë civile në interes të shërbimeve sociale për qytetarët në nevojë.

**Burimet financiare.** Shpenzimet në fushat që lidhen me mbrojtjen sociale janë relativisht të ulëta, nga te gjitha nivelet e financimit rreth 1,704,298. Ndërkaq, në përgjithësi, fushat që lidhen me përmirësimin e jetës së grupeve të ndjeshme dhe si rezultat gjithëpërfshirjen e tyre kanë mbetur relativisht të njëjta.

**Tabela 2: Ndarja e buxhetit sipas fushave përkatëse që prekin grupet e cenueshme në dy vitet e fundit dhe vitin pasues 2022**

Fushat specifike	2020	2021	2022
Infrastruktura publike	4, 226, 482	3, 980, 693	4, 238, 071
Zyra komunale për komunitete dhe kthim	47, 015	43,300	43, 270
Zhvillimi ekonomik	66, 433	52,300	111, 560
Planifikimi urban dhe mjedisi	208, 290	160,200	190, 200
Shëndetësia dhe mirëqenia	2, 184, 964	2,084,062	2, 105, 862
Shërbimet sociale rezidenciale	126, 669	88,000	88, 510
Arsimi dhe shkenca	8, 338, 975	7, 730, 800	8, 156, 139

**Shërbimet specifike në kuadër të Organizatave të Shoqërisë Civile.** Ekzistojnë disa shërbime sociale specifike që ofrohen nga OShC-të. Në nivel të ofrimit të asistencës me ushqim operon kuzhina në Janjevë në kuadër të organizatës Jetimat e Ballkanit. Në anën tjetër aktive janë edhe The IdeasPartnerships, ku përveç kopshtit ofrohen edhe kurse edukativo arsimore për grupet e marginalizuara (romë, ashkali, egjiptian, kroat) dhe aktivitete të këshillimit për gratë shtatzëna dhe vajza e reja për parandalim të martesave të hershme. Gjithashtu, përmes organizatës është mundësuar nga Komuna e Lipjanit punësimi i tre personave, staf profesional (psikolog, logoped, mësime mbështetëse).

Me fokus më të theksuar në gjendjen e të rinjëve, në komunë operon edhe YouthAssociationforHuman Rights me tri programe identifikuese të saj: programi për monitorim të institucioneve lokale, programi për demokratizim dhe programi për rini. Organizata ofron shërbime ditore, këshillim dhe pajisje të nevojshme për rreth 80 persona që përfaqësojnë grupet e të rinjtëve, personat me nevoja të veçanta dhe komunitete Romë, Ashkali dhe Serb.

Në anën tjetër, shoqërisë civile në Komunën e Lipjanit i mungojnë shërbime specifike për viktimat e dhunës së bazuar në gjini dhe dhunës familjare, shërbimet për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara, për përdoruesit e substancave psikoaktive dhe kategori të tjera të ndjeshme.

Mbështetja institucionale për organizatat e shoqërisë civile ofrohet në formën e granteve, por shuma në dispozicion dhe procedurat e gjata deri te hapat konkret në ofrimin e mbështetjes

financiare, shpesh ndikojnë në qëndrueshmërinë e shërbimeve sociale të ofruara nga organizatat. Në vitin 2022 është planifikuar rritja e buxhetit për mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile.

## IV. Vizioni dhe Objektivat Strategjike

Strategjia mbi Përfshirjen Sociale 2022 – 2024 është ndërtuar mbi vlerat dhe parimet që rrjedhin nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe legjislacioni në fuqi.

### Vizioni

*Transformimi i sistemit të mbrojtjes sociale në Komunën e Lipjanit nga ofrimi i shërbimeve të domosdoshme në ato që ofrojnë mbështetje për të gjithë personat në nevojë deri në përfshirjen e plotë në jetën institucionale dhe sociale.*

### Objektivat strategjike

#### **Objektivi I. Krijimi i qasjes së barabartë në shërbime sociale dhe familjare për personat në nevojë**

Qasja fizike në shërbime publike është një e drejtë elementare për të pranuar shërbimet e nevojshme, përfshinë eliminimin e barrierave infrastrukturore dhe arkitektonike, adaptimin e trotuareve, pajisjen e institucioneve kyçe me ashensor, pajisjen e rrugëve me sinjalizues dhe staza për të verbër dhe më e rëndësishmja sigurimin e shërbimeve në mobilitet për ata që e kanë të pamundur një gjë të tillë.

Si fazë e dytë që do të kontribuonte në qasjen adekuate në shërbime publike janë mundësia për shërbime të specializuara sipas nevojës, ku mundësitë e kontraktimit apo blerjes parashihen si shumë të rëndësishme në evitimin e problemit. Në anën tjetër, në këtë drejtim janë identifikuar disa sfida që pengojnë përfshirjen e plotë të grupeve të caktuara me nevoja specifike dhe që Komuna e Lipjanit duhet të ketë vëmendje të shtuar në përmbushjen e tyre pavarësisht nëse i takojnë fushës së shëndetësisë, mirëqenies sociale apo arsimit.

#### **Objektivi II. Krijimi i kushteve të barabarta në informim dhe komunikim për personat me nevoja specifike**

Personat me vështirësi në të pamur dhe dëgjuar kryesisht hasin në vështirësi të qasës në informacion publik pa praninë e një kujdestari apo ndihmësi. Planifikimi i shpalljes publike të njoftimeve duke iu përshtatur aftësive ndryshe të këtyre grupeve është kyq për përfshirjen e tyre në jetën publike. Në anën tjetër, parandalimi i dukurive negative sociale më të cilat përballen grupet e ndjeshme duhet të bëhet aktivisht përmes kampanjave të ndryshme dhe

shpërndarjes së materialeve edukuese/informative përshtatur grupeve dhe mënyrave më të përshtatshme të të mësuarit.

### **Objektivi III. Krijimi i një sistemi te posaçëm komunal të mbledhjes dhe menaxhimit të koordinuar të dhënave për personat me nevoja specifike;**

Mbledhja dhe menaxhimi i të dhënave nga të gjithë ofruesit komunal të shërbimeve është një proces që do të ndihmonte jo vetëm krijimin e një pasqyre të gjendjes reale, por edhe orientimin e politikave të komunës në përmirësimin e shërbimeve dhe tërheqjen e fondeve nga donator të jashtëm. Aktualisht mbledhja e të dhënave bëhet nga të gjitha institucionet dhe organizatat në mënyrë të pavarur. QPS ka databazat përkatëse, Drejtoria për Arsimit organizon të dhënat në mënyrë të pavarur, ndërsa organizatat jo-qeveritare ofrojnë shërbime të specializuara për grupe të ndryshme dhe dokumentojnë të dhënat në mënyrë dhe sistemin e organizuar nga vet organizatat. Krjimi i një sistemi/databaze të përbashkët për identifikimin dhe dokumentimin e të gjitha grupeve të ndjeshme dhe shërbimeve që pranojnë ato ka dalë si një prioritet i grupit punues, ku DShPS dhe QPS do të kishte primatin në organizimin e regjistrimit të të dhënave dhe kodimin për çështje etike, ndërsa akterët tjerë dhe organizatat jo-qeveritare do të kishin qasje me privilegje për të dokumentuar punën e tyre.

### **Objektivi IV. Sigurimi qëndrueshmërisë se shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera publike**

Disa aspekte të sistemit të mbrojtjes sociale cenojnë në përgjithësi funksionimin e ofruesve të shërbimeve sociale në realizimin adekuat të punës së tyre. Këto aspekte mund të kenë karakter objektiv, teknik apo njerëzor. Krjimi, funksionalizimi dhe mbështetja e programeve specifike për ofrim të shërbimeve të caktuara duhet të jetë prioritet i komunës në vitet pasuese. Në anën tjetër, Qendra për Punë Sociale duhet të ketë mbështetje të plotë në fuqizimin e saj përmes plotësimit të nevojave: me staf profesional, ngritje të kapaciteteve, kompenzimi i kujdestarisë, aspektet teknike si hapësirat e përshtatshme, pajisja me vetura dhe fondi për intervenime të shpejta. Ofruesit e shërbimeve sociale kryesisht janë angazhuar për shumë vite në punën me kategori të ndjeshme dhe kujdesi për mirëqenien e tyre nuk duhet anashkaluar në përpjekjet për përmirësimin e sistemit të mbrojtjes sociale. Mirëqenia mund të përfshijë supervizimin profesional dhe programet e menaxhimit të stresit. Në anën tjetër, përgatitja e tyre në formimin e qasjes sipas trendeve botërore bashkohore kërkon përgatitjen e ofruesve të shërbimeve në aplikimin e ndihmës së parë psikologjike dhe integrimin praktik/qasjes së informuar mbi traumën në punën e përditshme.

### **Objektivi V. Ofrimi i zgjidhjeve të qëndrueshme për personat me nevoja specifike dhe/ose aftësi të kufizuara për qasje në shërbime publike**

Ofrimi i shërbimeve sociale është pjesë e kyçe në përmirësimin e sistemit të mbrojtjes sociale, por krijimi i zgjidhjeve të qëndrueshme është parakusht për mosngarkesën e ofruesve të shërbimeve me raste të ndjeshme. Zhvillimi i programeve të ndërmarrësisë sociale dhe siguria e

qëndrueshmërisë së tyre mbesin një kanal i rëndësishëm drejtë përmbushjes së këtij ndryshimi të dëshiruar. Në përgjithësi orientimi i kapaciteteve dhe burimeve familjare të grupeve të ndjeshme në gjenerimin e të ardhurave dhe sigurimin e mirëqenies familjare ndihmon jo vetëm personat në nevojë, por në përgjithësi sistemin e mbrojtjes sociale dhe avansimin e shërbimeve specifike

Nr. 15-550/01-34127

Lipjan, më 29.06.2022

### KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

